



Pranuar / Dërguar Punësi/Prof. foto Received/Delivered	13.04.2021	1	viti god year
Organ /Njësia Organ /Unitet Org /Unit	Nr. Prot H. Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix	Sasia Kolicina Quantity
SKUMSHOK	1766/2021		113



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS  
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA  
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVA

A. Nr. 110/2021

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Eshref Shabani-anëtarë, me Rushit Kajtazi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.110/2021 të datës 01.03.2021 të parashtruar nga ankuesi kundër organit të punësimit Ministria e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, në çështjen administrative-juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nen paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nen paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datë 13.04.2021, unanimisht mori këtë:

V E N D I M

Hedhet poshtë si e palejuar ankesa me numër A.nr.110/2021 e datës 01.03.2021, e parashtruar nga ankuesi

A r s y e t i m

Ankuesi nëpunës civil në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me datë 01.03.2021 ka parashtruar ankesë me numër protokoll 854/2021 të regjistruar me A.nr.110/2021, në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil, e precizuar me datë 02.04.2021, kundër Vendimit me Nr.922/2020 të datës 12.11.2020 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me pretendimin ankimor se vendimi i kundërshtuar me ankesë është diskriminuese dhe në kundërshtim me Konventën Evropiane mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore, Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës më datë 03.03.2021 përmes shkresës me numër protokoll 927/2021 ka proceduar kërkesën për përgjigjen në ankesë të Ministrisë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës(me tej MPJD). Ndërsa më datë 12.03.2021 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin e ankesës ka administruar këto prova: Ankesën A nr. 110/2021, e datës 01.03.2021, me numër protokoll 854/2023, drejtuar Këshillit të Pavarur Mbikëqyrës për



Shërbimin Civil të Kosovës, e-mail kërkesën për plotësim të ankesës i datës 30.03.2021, Plotësimin Ankesa e datës 02.04.2021, Përgjigjen në Ankesë të datës 12.03.2021; Vendimin me numër 65/2009 të datës 23.11.2009, Vendimin nr. 51/2017 të datës 14.02.2017 të Ministrit të MPJ, Akt Emërimit me nr.113 të datës 07.08.2013, Vendimin me Nr. 922/2020 të datës 12.11.2020 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, Vendimin me numër Ref.58/2021 të datës 01.03.2021 të Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës Vendimi me numër ref.48/2021 i datës 23.02.2021 i Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të MPJD, i Emali i datës 02.03.2021 nga A.K për K.K dhe E-maili i datës 12.04.2021.

Kolegji për Shqyrtimin e Ankesave pasi ka analizuar të gjitha shkresat e lëndës të parashtruara nga palët, ka konstatuar se ankesa e ankuesit *hedhet poshtë si e palejshme, sepse:*

Bazuar në provat e lëndës, gjegjësisht bazuar në Akt Emërimit me Nr.113 të datës 07.08.2013, Kolegji ka gjetur se ankuesi është i emëruar në pozitën e Zyrtari i Lartë Ligjor, në Departamentin për Çështje Ligjore, Traktate dhe të Drejtat e Njeriut pranë Ministrisë së Punëve të Jashtme.

Me Vendimin Nr.51/2017 të datës 14.02.2017 të Ministrit të Ministrisë së Punëve të Jashtme, ankuesi është caktuar të shërbejë nga data 01.03.2017 në gradën diplomatike "Këshilltar" në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Britani të Madhe.

Ministrja e MPJD më datë 12.11.2020 ka nxjerrë Vendimin me Nr.922/2020, me të cilin ka vendosur për kthimin e ankuesit nga misioni diplomatik me datë 01.03.2021 për arsye të përfundimit të mandatit të tij si Këshilltar në Ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër/Britani të Madhe.

Zv. Sekretari i Përgjithshëm i MPJD në zbatim të Vendimit Nr.922/2020 të datës 12.11.2020 të Ministres së MPJD, me Vendimin Nr.ref.58/2021 të datës 01.03.2021 ka bërë sistemin e përhershëm të ankuesit në pozitën e Zyrtarit të Lartë për Parlamentin Evropian dhe Vendet jo anëtare të DE-së, në Departamentin për Evropë dhe BE.

Ankuesi në ankesën e tij të precizuar me datë 02.04.2021, ka atakuar Vendimin me Nr. 922/2020 të datës 12.11.2020 të Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, me pretendimin që i njëjti të rishqyrtohet dhe ankuesit ti vazhdohet qëndrimi në Londër edhe për 4 muaj respektivisht deri në përfundimin e rregullt të vitit shkollor të dy fëmijëve të tij. Me tutje shton se vendimi i kundërshtuar me ankesë është diskriminues dhe në kundërshtim me Konventën Evropiane mbi të Drejtat dhe Liritë Themelore, Kushtetutën e Kosovës dhe Ligjin Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë.

Bazuar në dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, përkatësisht nenin 24 paragrafi 3 të këtij Ligji, çdo nëpunës civil ka të drejtë të paraqesë ankesë në KPMSHC për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto, që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil. Ndërsa Ligji Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, respektivisht neni 127 paragrafi 1 përcakton se: *1. Ankesa duhet të parashtrohet brenda tridhjetë (30) ditëve nga data kur pala është njoftuar për aktin administrativ.*

Duke nisur nga fakti se Vendimi i atakuar Nr.922/2020 i Ministres së Punëve të Jashtme dhe Diasporës, është nxjerr me datë 12.11.2020, dhe se i njëjti i është dërguar ankuesit me datë 11.12.2020 përmes adresës elektronike zyrtare, Kolegji konstaton se ankesa e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës me datë 01.03.2021 është



ushtruar jashtë afatit ligjor të përcaktuar me nenin 127 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

Andaj, bazuar ne rrethanat si me lartë si dhe duke u bazuar në nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.7 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, Kolegji vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë - Departamenti për Çështje Administrativ, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk e ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

## KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS

Lënda Nr. A. Nr. 110/2021

Rushit KAJTAZI

*Procesmbajtës*

Ardita Haxhnikaj DEMI

*Ardita Haxhnikaj*  
Kryetare e Kolegjit

### Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Ministres së Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Zv. Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Udhëheqësit të Personelit në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe Diasporës;
- Arkivit të KPMSHCK-së

